

# Përgatitje personale për bisedën ndërmjet prindërit dhe mësuesit në shkollë

## Planifikimi i përbashkët i bisedës

Emri i nxënësës/i nxënësit: .....

Të gjithë ata, të cilët marrin pjesë në bisedë në shkollë, do të marrin një formular të këtillë të cilin duhet ta sjellin me vete të plotësuar. Nëse diçka është e pa kuptueshme ose vështirë për tu vlerësuar, atëherë lëroni atë vend të zbratur dhe kaloni në pikën tjetër. Formulari personal parapregatitës, mund të merret përsëri me vete mbas bisedës. Ai i takon atij personi që e ka plotësuar.

Data e zhvillimit të bisedës: .....

### Përshkrimi im i situatës së tanishme i përmbledhur shkurt:

Plotëso  
1-2 katrorë Nacionet që janë veçanërisht të rëndësishëm, mund të nënvizohen

Këtu ju mund të shkruani shkurtimisht në fushat e veçanta vëzhgimet dhe vërejtjet eventuale:

I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Të mësuarit në përgjithësi</b> Fëmija mundet të dëgjoj, të sheh, të ndjejë; të jetë i vëmendshëm; të vërejë dhe të rikrijojë vargje, melodi, lëvizje; të emërtojë, ti përshkruajë dhe të paraqet forma; ti hulumtojë gjërat dhe marrëdhëniet nëpërmjet lojrave; të gjejë zgjidhje dhe ti zbatojë ato; të përdorë strategji; të planifikojë; të ushtrojë
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Aftësitë gjuhësore dhe formimi i nocioneve</b> Fëmija mundet të përsërisë fjalët me përpikmëri; të kuptojë qëllimin e fjalëve dhe simboleve; të formojë fjali korrekte; të krijojë leksikun sipas moshës përkatëse; të modulojë gjuhën sipas ndjenjave përkatëse (në gjuhën e parë dhe të dytë)
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Të mësuarit matematikor</b> Fëmija mundet të numërojë; të orientohet në hapësira të ndryshme (prapa/para, lartë/poshtë); të evidentojë madhësitë dhe sasi të rëndësishme ato sipas kriterëve të veta apo të dhëna; të orientohet në hapësirën e numrave; të njeh rregullsitë e numrave
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Reagimi ndaj kërkesave</b> Fëmija mundet të shtjellojë një detyrë vetë ose në grup; të marrë përgjegjësi; të respektojë programin ditor; të thellohet në një detyrë; të komandojë sjelljen e vet; të sillt me gëzim dhe frustrimin
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Komunikimi</b> Fëmija mundet të kuptojë se çfarë shprehin dhe thonë të tjerët (joverbal dhe verbal); të shprehë mendimet ashtu, që të tjerët të mund ta kuptojnë (joverbal dhe verbal); të bisedojë dhe diskutojë me moshatarët dhe të riturit
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Lëvizshmëria dhe mobiliteti</b> Fëmija mundet të planifikojë rrjedhat e lëvizjeve të përgjithshme motorike, ti koordinojë dhe përsërisë; të planifikojë lëvizjet në aftësitë motorike në punët e imta, ti koordinojë dhe përsërisë; ti përdorë me kujdes mjetet e vizatimit dhe shkrimit
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Kujdesja për vetëveten</b> Fëmija mund t'i veshë dhe xhveshë teshat respektivisht t'i mbathë dhe zbathë këpucët kur të dojë; të kujdeset për të ushqyerit, mirëmbajtjen e trupit dhe shëndetit; të mbrohet nga situatat e rrezikshme
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Sjellja me njerëzit</b> Fëmija mundet të lidhë kontakte me njerëz të tjerë; të tregojë dhe pranojë kujdes, ngrohtësi dhe tolerancë; të rregullojë afërsinë dhe distancën; të sillt me kritikë; të gjejë shokë dhe ti mbajë kontaktet me ta
I fortë ↑ ↓ Problem	<b>Koha e lirë, zbavitja dhe shoqëria</b> Fëmija mundet të marrë pjesë në jetën e përbashkët në shkollë, familje dhe me fqinjët; të përfshihet në lojra dhe aktivitete të tjera në kohën e lirë; të kujdeset për aktivitetet e tij të preferuara